

## Shoqëri Civile Aktive në Menaxhimin e Shërbimeve Mjedisore

Promovimi i një rrjeti organizatash dhe aktiviteteve vendore për menaxhim më të mirë të shërbimeve mjedisore në Shqipëri

### Problemi aktual

Shqipëria përballet ende me sfida të shumta lidhur me mjedisin: keqmenaxhim i mbetjeve, mungesë kanalizimesh dhe shkarkime në ujërat e pastër të lumenjëve, respektim i ulët i hapësirave publike, dhe nivele tepër të larta të ndotjes. Përveç kësaj, mungojnë të dhënat dhe matje teknike të sakta. Në një kohë kur legjislati po përparon dhe janë prezantuar standarte të reja, ka një nevojë të madhe për plane të qarta veprimi që përfshijnë edhe shoqërinë civile. Bashkëpunimi midis qeverisjes vendore dhe rajonale dhe organizatave civile është i pamjaftueshëm dhe publikut i jepet shumë pak informacion.

### Rrjeti i Aftësuar

Kjo gjendje nxiti Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC), për t'u përgjigjur në bashkëpunim me Ambasadën Suedeze. Në projektin SENIOR-A ato nisën të mbështetnin organizatat e shoqërisë civile në fushën e menaxhimit të shërbimeve mjedisore. Qëllimi kryesor është promovimi i një rrjeti të organizatave i cili është i përgatitur për të përmirësuar menaxhimin e shërbimeve mjedisore dhe për të nxitur përgjigje lokale për gjendjen aktuale. Rezultatet e pritshme përfshijnë:

- Bashkëpunim i rritur midis qeverisjes vendore dhe rajonale, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë
- Të dhënat dhe matje mbi ndotjen të jenë në dispozicion dhe të unifikuar
- Rrjeti i OJF-ve merr pjesë në plane dhe strategji
- Numër i rritur i kanaleve të informacionit dhe ndërgjegjësimit dhe angazhim i mediave lokale



### Harta mjedisore

Organizatave të shoqërisë civile mund të shërbejnë si hallkat munguese midis institucioneve qeveritare dhe publikut. Një risi e projektit është monitorimi dhe vlerësimi mjedisor i cili do të rezultojë në të dhëna të sakta dhe në një hartë për "zonat e nxehta" mjedisore. Ekspertët hartojnë problemet lidhur me menaxhimin e shërbimeve dhe krijojnë bazën e të dhënave me qëllim furnizimin e planeve efektive. Të dhënat nga 5 rajone të përzgjedhura unifikohen në mënyrë që të lejonjë krahasimin. Kjo ndihmon në përgatitjen e një plani më të mirë për secilën zonë.

### Angazhimi i publikut

Një komponent tjetër i nevojshëm është angazhimi i publikut dhe medias në planifikimin e veprimeve të duhura për zgjidhjen e problemeve mjedisore. Interesi i publikut duhet të kapet dhe për këtë informacioni do të mundësohet nëpërmjet internetit, mediave tradicionale dhe takimeve të hapura. Gjithashtu, qëndrat e informimit publik, tabelat dhe ditët e veçanta për mjedisin do të ndikojnë në angazhimin direkt të komunitetit. Një publik më i ndërgjegjësuar është rezultati i dëshiruar i këtij projekti.

### FAKTET KRYESORE

#### DONATORË:

- ✓ Qendra Rajonale e Mjedisit (REC)
- ✓ Ambasada Suedeze

#### PARTNERËT:

- ✓ Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Lokal - AULEDA
- ✓ Fondacioni Gjirokastra
- ✓ Sot për të ardhmen OJF
- ✓ Tjetër Vizion – Elbasan
- ✓ Unë Gruaja - Pogradec

#### KOHËGJATJA:

Mars 2014 – në vazhdim

#### PËRFITUESIT:

- ✓ Banorët
- ✓ Njësitë e qeverisjes vendore

#### KONTAKT:

Zana Vokopola  
Drejtor Ekzekutiv

Urban Research Institute

Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: uri@uri.org.al  
Web: www.uri.org.al

### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Në kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.